VENDIM
Nr.113, datë 24.9.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HIDROINVEST 1" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa "a", dhe pika 8, si dhe 18 pika 1, germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14, të rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.9.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hidroinvest 1" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, për HEC Stranik me fuqi 1600 kW dhe HEC Zall Tore me fuqi 2600 kW,

konstatoi:

1. Paraqitjen e plotë të dokumentacionit sipas rregullores për procedurat e licencimit, nga shoqëria Hidroinvest 1 sh.p.k. në datën 30.7.2008, për licencimin për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

2. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të "Hidroinvest 1" sh.p.k. për t'u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike për HEC Stranik me fuqi 1600 kW dhe HEC Zall Tore me fuqi 2600 kW, ka nisur me marrjen e vendimit nr.92, datë 6.8.2008.

3. Rregullorja për procedurat e licencimit, e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "HIDRO Invest 1" sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike për:

a) HEC Stranik me fuqi 1600 kW;

b) HEC Zall Tore me fuqi 2600 kW.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Afati për fillimin e ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga të dy HEC-et të jetë jo më vonë se data 1.10.2009.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta